

Objektivat drejt dekarbonizimit

Analizë me rekomandime mbi Planin Kombëtar të Kosovës për Energji dhe Klimë



Objektivat drejt dekarbonizimit

Analizë me rekomandime mbi Planin Kombëtar të Kosovës për Energji dhe Klimë

Autore: Diona Grezda
Qershor 2024, Prishtinë, Kosovë

Akronimet

ALPEX	Bursa Shqiptare e Energjisë
BE	Bashkimi Evropian
BPV	Bruto Produkti Vendor
BRE	Burimet e Ripërtëritshme
CO2	Dioksidi i karbonit
ETS	Sistemi i Tregtimit të Emisioneve të BE-së
KEDS	Kompania Kosovare për Distribuim të Energjisë Elektrike në Kosovë
PKEK	Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë
MV	Megavat
WB6	Gjashtë Shtetet e Ballkanit Perëndimor

‘Tranzicioni energjetik dhe objektivat drejt dekarbonizimit’ është zhvilluar me mbështetjen e projektit rajonal “SMART Balkans – Shoqëria Civile për Vlera të Përbashkët në Ballkanin Perëndimor” të zbatuar nga Qendra për Promovimin e Shoqërisë Civile (CPCD) në bashkëpunim me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe Qendrën për Kërkim dhe Politikëbërje (CRPM) dhe i mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme e Norvegjisë (NMFA). Përmbajtja e analizës është përgjegjësi e vetme e zbatuesve të projektit, Balkan Green Foundation dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme Norvegjeze (NMFA).

Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive	4
Prapavijë	5
Analizë me rekomandime për tranzicionin energjetik të Kosovës	7
1. 1. Përcaktimi i saktë i hapave të tranzicionit për secilin sektor	9
1.2. Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi i akterëve për qëllimet e përbashkëta	10
1.3. Targetimi i duhur i grupeve të ndjeshme më të afektuara nga tranzicioni	11
1.4. Investim në shkencë, inovacion dhe teknologji	13
1.5. Rritja e pjesëmarrjes së burimeve të ripërtëritshme të energjisë	13
1.6. Diversifikimi i burimeve të energjisë	15
1.7. Targetimi i konsumit të tepërt të energjisë	16
1.8. Avancimi i kornizës ligjore	17
1.9. Dekarbonizimi në sektorin e transportit dhe të ngrohjes	18
Konkluzione	19

Përmbledhje Ekzekutive

Krahas shteteve të tjera të Ballkanit Perëndimor, Kosova është zotuar që të arrijë dekarbonizimin deri në vitin 2050 përmes Deklaratës së Sofjes së vitit 2020. Në këtë rrugëtim të saj in drejt harmonizimit me legjislacionin e BE-së, Kosova pritet që t'i arrijë caqet e vendosura nga Këshilli i Ministror i Komunitetit të Energjisë për vitin 2030, më saktësisht të ulë emetimet e gazrave serrë për 60.9% nën nivelet e vitit 1990, të rrisë në 31% pjesëmarrjen e burimeve të ripërtëritshme në bruto konsumin e final të energjisë dhe të mbajë konsumin primar të energjisë në 129.88 Mtoe, ndërkaq atë final në 79.06 Mtoe në nivel të Komunitetit të Energjisë.

Kosova ka bërë një hap shumë të rëndësishëm me miratimin e Strategjisë për Energji (2022-2031) dhe punën në draftimin e Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë (PKEK-ut). Megjithatë, të dyja këto dokumente strategjike, dhe në përgjithësi procesi i tranzicionit energjetik kërkojnë përcaktim më të qartë të hapave dhe masave drejt arritjes së objektivave për vitin 2030 dhe 2050 në nivel të Komunitetit të Energjisë dhe të Bashkimit Evropian. Kriza energjetike ka nxjerrë në pah shumë aspekte e sfida, me të cilat Kosova ballafaqohet tash e sa vite. E njëjta ka ngritur vetëdijesim lidhur me efikasitetin e energjisë, nevojën urgjente për të ngritur pjesëmarrjen e burimeve të ripërtëritshme dhe rritjen e sigurisë së furnizimit.

Prandaj, duke njohur rëndësinë e kalimit në energji të pastër dhe të harmonizimit me politikën dhe legjislacionin e BE-së për energji dhe klimë, Qeveria duhet të fokusohet në rritjen e bashkëpunimit në nivel të brendshëm dhe të jashtëm dhe avancimin e kornizës ligjore për arritjen e objektivave të përbashkëta. Rritja e pjesëmarrjes së burimeve të ripërtëritshme, targetimi i konsumit të tepërt të energjisë, si dhe diversifikimi i burimeve janë aspekte të rëndësishme të këtij tranzicioni. Prandaj, është edhe shumë e rëndësishme të definohen saktë hapat për secilin sektor në Planin Kombëtar për Energji dhe Klimë, si dokument strategjik që do ta udhëheqë Kosovën në 10 vitet e ardhshme. Për më tepër, një fokus i shtuar duhet të vihet në targetimin e grupeve më të ndjeshme të shoqërisë (gratë, të rinjtë dhe grupet e tjera të afektuara nga tranzicioni) në mënyrë që asnjë person të mos mbetet prapa në këtë proces.

Ky raport synon të ofrojë rekomandime që do t'i shërbejnë Kosovës në arritjen e objektivave për vitin 2030 dhe 2050 në nivel të Komunitetit të Energjisë dhe të Bashkimit Evropian. Këto rekomandime dalin nga analizimi i dokumenteve, mbi të gjitha i Strategjisë së Kosovës (2022-2031) dhe i draft-Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë, por edhe prej intervistave me ekspertë të fushës. Duke identifikuar sfidat dhe mangësitë në sektorë dhe politika të caktuara, kjo analizë synon të nxisë ndryshime pozitive në procesin e tranzicionit të energjisë në vend.

Prapavijë

Gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor, njëkohësisht edhe palë kontraktuese të Komunitetit të Energjisë (Kosova, Maqedonia e Veriut, Bosnja dhe Hercegovina, Shqipëria, Mali i Zi dhe Serbia) kanë nënshkruar Deklaratën e Sofjes për Agjendën e Gjelbër në nëntor të vitit 2020.¹ Përmes këtij dokumenti, palët kanë shprehur angazhimin e tyre për të punuar drejt objektivit të Bashkimit Evropian (BE-së) për një kontinent me 0 emetime deri në vitin 2050. Për më tepër, palët janë zotuar për të shtuar pjesëmarrjen e burimeve të ripërtëritshme dhe për t'i ofruar kushtet e nevojshme për të mundësuar investimet në këtë sferë.² Një hap shumë i rëndësishëm në këtë rrugëtim të shteteve të Ballkanit Perëndimor është miratimi i caqeve për vitin 2030 nga ana e Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë në dhjetor të vitit 2022.³ Si rrjedhojë, palët kontraktuese pritet që t'i ulin emetimet e gazrave serrë për 60.9% nën nivelet e vitit 1990, ta rrisin në 31% pjesëmarrjen e burimeve të ripërtëritshme në bruto konsumin final të energjisë dhe ta mbajnë konsumin primar të energjisë në 129.88 Mtoe, ndërkaq atë final në 79.06 Mtoe, në nivel të Komunitetit të Energjisë.⁴

Pala kontraktuese

Caqet për vitin 2030 lidhur me emetimet e gazrave serrë

	<i>ulja (%) nga vlerat e vitit 1990</i>	<i>milione tonë metrikë ekuivalentë të dioksidit të karbonit</i>
Shqipëria	+53,2%	12,00 MtCO ₂ eq
Bosnja dhe Hercegovina	-41,2%	15,65 MtCO ₂ eq
Kosova ⁵	-16,3%	8,95 MtCO ₂ eq
Mali i Zi	-55,0%	2,42 MtCO ₂ eq
Maqedonia e Veriut	-82,0%	2,20 MtCO ₂ eq
Serbia	-40,3%	47,82 MtCO ₂ eq
Gjithsej	-60,9%	427,64 MtCO ₂ eq

¹ Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, Deklarata e Sofjes për Axhendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor. <https://www.rcc.int/docs/546/sofia-declaration-on-the-green-agenda-for-the-western-balkans-rn>. 22 dhjetor 2023.

² Po aty.

³ Këshilli Ministrave të Komunitetit të Energjisë miraton caqet ambicioze të energjisë dhe klimës për 2030 dhe paketën e tregut të energjisë elektrike. Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, Deklarata e Sofjes për Axhendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor. <https://www.rcc.int/docs/546/sofia-declaration-on-the-green-agenda-for-the-western-balkans-rn>. 22 dhjetor 2023.

⁴ Komuniteti i Energjisë vendos të miratojë objektivat e Energjisë dhe Klimës 2030 në Këshillin Ministror të Dhjetorit. <https://www.energy-community.org/news/Energy-Community-News/2022/09/01.html>. 22 dhjetor 2023.

⁵ Po aty.

Pala kontraktuese	<i>2005 Pjesëmarrja e burimeve të ripërtëritshme</i>	<i>2020 Caku i pjesëmarrjes së burimeve të ripërtëritshme</i>	<i>2030 Caku i pjesëmarrjes së burimeve të ripërtëritshme</i>
Shqipëria	31,2%	38%	52,0%
Bosnja dhe Hercegovina	34,0%	40%	43,6%
Kosova ⁶	18,9%	25%	32,0%
Mali i Zi	26,3%	33%	50,0%
Maqedonia e Veriu	17,2%	23%	38,0%
Serbia	21,2%	27%	40,7%
Gjithsej			31,0%

Pala kontraktuese	<i>2020 Konsumi primar i energjisë</i>	<i>2020 Konsumi final i energjisë</i>	<i>2030 Pjesëmarrja maksimale e konsumit primar të energjisë</i>	<i>2030 Pjesëmarrja maksimale e konsumit primar të energjisë</i>
Shqipëria	2,15	1,86	2,60	2,40
Bosnja dhe Hercegovina	7,00	4,34	6,50	4,34
Kosova ⁷	4,70	4,25	2,70	1,80
Mali i Zi	0,99	0,70	0,92	0,73
Maqedonia e Veriu	2,54	1,83	2,30	2,00
Serbia	15,18	9,08	14,94	9,54
Gjithsej	120,69	72,93	129,88	79,06

⁶ Për Kosovën si vit bazë është përdorur viti 2016.

⁷ Për Kosovën si vit bazë është përdorur viti 2016.

Në rrugën e tyre drejt harmonizimit të legjislacionit nacional me atë të BE-së (EU Acquis), këto shtete pritet të punojnë edhe në Planet Kombëtarë për Energji dhe Klimë (PKEK). PKEK-u paraqet një plan kombëtar 10-vjeçar, që u prezantua në vitin 2018 dhe që përcakton mënyrën se si një shtet i BE-së pritet t'i arrijë objektivat e energjisë dhe klimës për vitin 2030, por gjithmonë duke integruar perspektivën e BE-së për vitin 2050. Në këtë drejtim PKEK-u për shtetet e Ballkanit Perëndimor mbulon 5 shtyllat e Unionit të Energjisë:⁸

- Dekarbonizimin (përfshirë burimet e ripërtëritshme - BRE);
- Efiçencën e energjisë;
- Sigurinë e energjisë;
- Tregun e brendshëm të energjisë; dhe
- Hulumentimin, inovacionin dhe konkurrencën.⁹

Në përgjithësi, shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë shënuar progres minimal sa i përket planeve kombëtare për energji dhe klimë. Deri më tash, vetëm Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut kanë dorëzuar versionet finale të PKEK-ve të tyre, ndonëse jo brenda afateve fillestare.¹⁰ Sa i përket Kosovës, Serbisë, Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Malit të Zi, janë në faza të ndryshme të përgatitjeve.¹¹

Nëse fokusohemi vetëm te rasti i Kosovës: është dorëzuar drafti i PKEK-ut në korrik të vitit 2023 në Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, ndërkaq në dhjetor ka pranuar rekomandimet nga ana e Sekretariatit.¹²

Analizë me rekomandime për tranzicionin energjetik të Kosovës

Kosova u prin shteteve të Ballkanit Perëndimor për nga varësia me thëngjill, që gjatë dekadës së fundit përbënte 77.7 për qind të furnizimit të përgjithshëm të energjisë.¹³ Për më tepër, Kosova ka konsum të lartë të energjisë në raport me Bruto Produktin Vendor (BPV-në) dhe me numrin e popullsisë, për shkak të një numri faktorësh, përfshirë: humbjet e mëdha në rrjet, ndërtesat joefiçente dhe pajisjet joefiçente.¹⁴

⁸ Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë (PKEK) – Komisioni Evropian. https://energy.ec.europa.eu/topics/energy-strategy/national-energy-and-climate-plans-necps_en. 22 dhjetor 2023.

⁹ "Dy Vite pas Sofjes: Progres i Kufizuar i Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë në Ballkanin Perëndimor, Raporti i ri nga CAN Europe Paralajmëron." CAN Europe, 10 nëntor 2022, <https://caneurope.org/wb-necp-report-2022/>

¹⁰ Po aty.

¹¹ Po aty.

¹² Qeverisja dhe PKEK. <https://www.energy-community.org/implementation/package/NECP.html>. 10 janar 2024.

¹³ Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Raporti Vjetor 2022. 20 nëntor 2023.

¹⁴ Qeveria e Republikës së Kosovës. Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031. <https://me.rks-gov.net/energija/>. 3 tetor 2023.

Sipas të dhënave të vitit 2022, humbjet teknike në rrjetin e shpërndarjes ishin 12.21% (mesatarja e BE-së është 6-8%) dhe ato komerciale 10.42% (prej të cilave 5.85% nga energjia elektrike e pafaturuar në komunat në veri të Kosovës).¹⁵ Sa i përket burimeve të energjisë së ripërtëritshme, ato përbëjnë vetëm 6.3% të energjisë elektrike.¹⁶ Në fund të vitit 2021, Kosova kishte 249.2MV energji të gjeneruar nga burimet e ripërtëritshme, prej të cilës 101MV nga uji, 137MV nga era, 10MV nga dielli/solare dhe 1.2MV nga biomasa.¹⁷

Varësia e madhe nga qymyri dhe pamundësia për t'i mbuluar të gjitha nevojat aktuale të energjisë me burime të ripërtëritshme, e bën ndërlihdhjen (interkoneksionin) me shtetet e tjera - në këtë rast Shqipërinë - tejet të rëndësishme për Kosovën. Nga dhjetori i vitit 2020, Kosova funksionon si Zonë e pavarur rregulluese në kuadër të Evropës Kontinentale brenda bllokut Shqipëri - Kosovë (AK). Një hap shumë i rëndësishëm i vendit drejt liberalizimit të tregut është edhe pjesëmarrja në Bursën Shqiptare të Energjisë ALPEX, e cila pritet të sigurojë zbatimin e objektivave të BRE-ve në mënyrë më kosto-efektive dhe rritjen e fleksibilitetit të sistemit.¹⁸

Në rrugën e saj drejt harmonizimit me politikat e gjelbra të BE-së për një ekonomi neutrale ndaj karbonit deri në vitin 2050 Kosovës i duhet dyfish përpjekje, sidomos konsideruar varësinë e madhe nga thëngjilli. Në mars të vitit 2023 dhe pas shumë vonesash, Parlamenti i Kosovës bëri një hap shumë të rëndësishëm në tranzicionin energjik të Kosovës, përmes miratimit të Strategjisë së Energjisë, që përbën një dokument themelor për përcaktimin e drejtimeve dhe veprimeve kyçe të vendit për zhvillimin e sektorit të energjisë në 10 vitet e ardhshme.¹⁹

Si e tillë, Strategjia fokusohet në pesë objektiva strategjikë: (1) Përmirësimi i qëndrueshmërisë së sistemit; (2) Dekarbonizimi dhe promovimi i energjisë së ripërtëritshme; (3) Rritja e efikasitetit të energjisë; (4) Forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe funksionimi i tregut; dhe (5) Mbrojtja dhe fuqizimi i konsumatorëve dhe zhvillimi i fuqisë punëtore.

Objektivat e tillë strategjikë, por edhe nismat e tjera strategjike, Kosova i ka të përcaktuara në PKEK si dokument gjithëpërfshirës, që supozohet ta drejtojë atë drejt një të ardhme të qëndrueshme.²⁰

¹⁵ Republika e Kosovës. Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë 2025-2030, versioni përfundimtar. <https://www.energy-community.org/implementation/package/NECP.html>.

¹⁶ Qeveria e Republikës së Kosovës. Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës 2022-2031. <https://me-rks-gov.net/energjia/>. 3 tetor 2023.

¹⁷ Komisioni Evropian. Raporti i Kosovës* 2022. <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Kosovo%20Report%202022.pdf>.

¹⁸ Qeveria e Republikës së Kosovës. Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës 2022-2031. <https://me-rks-gov.net/energjia/>. 3 tetor 2023.

¹⁹ Po aty.

²⁰ Republika e Kosovës. Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë 2025-2030, versioni përfundimtar. <https://www.energy-community.org/implementation/package/NECP.html>.

Kosova e ka dërguar draftin e saj të PKEK-ut në Sekretariat të Komunitetit të Energjisë më 10 korrik 2023, ndërkaq në fund të muajit dhjetor ka pranuar rekomandimet nga Sekretariati.²¹

Rekomandimet e ofruara në këtë analizë përgjithësisht janë në linjë me rekomandimet e Sekretariatit, sidomos sa i përket nevojës për përfshirje të vlerave kuantitative të ndikimit të secilës masë/politikë drejt arritjes së objektivave për vitin 2030 dhe 2050. Pra, Sekretariati rekomandon formulimin e politikave dhe masave në mënyrë më të konkretizuar, duke shpjeguar detajisht hapat dhe veprimet sidomos sa i përket energjisë së ripërtëritshme, efikasitetit të energjisë dhe funksionimit të tregut të brendshëm.²² Për më tepër, përfshirja e zotimit për largim të qymyrit deri në 2050, integrimi i aspekteve të tranzicionit të drejtë, rritja e targeteve sektoriale për pjesëmarrjen e BRE-ve në transport dhe ngrohje, dhe definimin e targeteve më të qarta në hulumtim, inovacion dhe konkurrencë janë çështje të tjera që rekomandohen nga Komuniteti i Energjisë.²³

Në vijim janë paraqitur disa nga çështjet e identifikuara nga analizimi i Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë të Kosovës dhe i Strategjisë për Energji dhe janë ngritur çështje e rekomandime që i kontribuojnë Kosovës në tranzicionin energjetik dhe arritjen e objektivave në kuadër të Komunitetit të Energjisë dhe legjislacionit të BE-së.

1. 1. Përcaktimi i saktë i hapave të tranzicionit për secilin sektor

Draft-Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë është shumë shpjegues, megjithatë nuk i ka të konkretizuar hapat e tranzicionit për secilin sektor. Kosova, sikurse secila palë kontraktuese e Komunitetit të Energjisë, i ka të përcaktuara caqet për vitin 2030,²⁴ mirëpo nuk ka një trajektore të qartë të procesit drejt këtyre caqeve. Një përcaktim më i detajuar i drejtimit të duhur, i shpejtësisë dhe sidomos i mekanizmave të financimit të tranzicionit në secilin sektor - i shprehur në vlera kuantitative - është qenësor për të mundësuar rezultate konkrete.

Strategjia e Energjisë 2022-2031 vendos si objektiv rritjen e pjesëmarrjes së burimeve të ripërtëritshme (BRE) në konsumin e sektorit të energjisë elektrike në 35% deri në vitin 2031, nga 6% që ishte në vitin 2021.²⁵ Strategjia dhe PKEK-u po ashtu përmendin ankandet solare si mekanizëm mbështetës për këto investime, megjithatë vonesat në proces po krijojnë pikëpyetje në atë se si pritet të arrihet targeti për BRE, a do të arrihet plotësimi i nevojave të energjisë me burime të ripërtëritshme, si dhe si do të ndikojë kjo në stabilitetin e furnizimit dhe kë e afekton.

²¹ Qeverisja dhe PKEK. <https://www.energy-community.org/implementation/package/NECP.html>. 22 dhjetor 2023

²² Po aty.

²³ Po aty.

²⁴ Objektivat e Paketës për Energjinë e Pastër. <https://www.energy-community.org/implementation/package/CEP.html>. 22 dhjetor 2023.

²⁵ Qeveria e Republikës së Kosovës. Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës 2022-2031. <https://me.rks-gov.net/energija/>. 3 tetor 2023.

Kur flasim për dekarbonizim, ka po ashtu mungesë të hapave konkret që Kosova duhet t'i ndërmarrë për të arritur dekarbonizimin e plotë deri në vitin 2050, cilat masa dhe mekanizma do t'i implementojë për një tranzicion të drejtë e që nuk lë asnjë person prapa dhe cilat instrumente financiare ka Kosova në dispozicion që i duhen për një tranzicion të drejtë. Po ashtu, është i nevojshëm planifikimi i procesit të largimit të qymyrit dhe kryerja e analizave për të kuptuar se si pritet të mbulohen nevojat e energjisë me burime të ripërtëritshme brenda afateve kohore, duke pasur parasysh kapacitetet ekzistuese të vendit dhe barrierat legjislative e administrative. Për më tepër, vetë Sekretariati, në rekomandimet për draft-PKEK, ka kërkuar të integrohet zotimi për largim të qymyrit deri në 2050 dhe arritja e zero emetimeve në po të njëjtin vit, për të siguruar konsistencë me Strategjinë e Energjisë së Kosovës.²⁶ Kjo meqë projeksionet janë bërë vetëm deri në vitin 2040 dhe, si rrjedhojë, mungojnë hapat që do të ndërmerren për largimin e plotë të qymyrit deri në 2050.²⁷ Një aspekt shumë i rëndësishëm në drejtim të dekarbonizimit është edhe studimi për efektet e Mekanizmit të Rregullimit të Kufirit të Karbonit të Bashkimit Evropian (CBAM), apo zbatimit të çmimeve të karbonit, i cili veç se është publikuar në Prill të 2024.²⁸

Një plan më i strukturuar dhe një analizë më e thellë e sektorëve mundëson aplikim të një qasjeje më gjithëpërfshirëse në tranzicion dhe dizajnim të masave specifike për Kosovën, bazuar në karakteristikat mjedisore dhe profilin e potencialet e saj të energjisë. Në të kundërt, është e vështirë të matet progresi i Kosovës në procesin e dekarbonizimit e sidomos në të qëndruarit prapa zotimeve për vitet 2030 e 2050 nëse nuk janë të përcaktuara saktë masat dhe politikat që do të aplikohen.

1.2 Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi i akterëve për qëllimet e përbashkëta

Kosova është e vendosur të punojë drejt tranzicionit në teknologjitë me emetime të ulëta, duke rritur përdorimin e energjisë së ripërtëritshme, duke implementuar masat e efikasitetit të energjisë dhe duke hequr lëndët djegëse.²⁹ Objektiva të tillë kërkojnë bashkëpunim dhe bashkëveprim nga ana e të gjithë akterëve, përfshirë edhe publikun. Një nivel i lartë i bashkëpunimit mundëson që tranzicioni të jetë i drejtë dhe të mos e lërë asnjë prapa. Një qëllim i tillë materializohet përmes dizajnit të skemave mbështetëse për ta parandaluar varfërinë energjetike, si: investimi në infrastrukturë të re, ofrimi i mbështetjes financiare, ofrimi i mundësive për punësim dhe riaftësimi i fuqisë punëtore.

30

²⁶ Po aty.

²⁷ Po aty.

²⁸ Po aty.

²⁹ Po aty.

³⁰ Mekanizmi i Tranzicionit të Drejtë - Komisioni Evropian. https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/priorities-2019-2024/european-green-deal/finance-and-green-deal/just-transition-mechanism_en. 22 dhjetor 2023.

Bashkëpunimi i akterëve është i nevojshëm të zhvillohet në dy nivele: (1) në nivel të shtetit - bashkëpunim i brendshëm; (2) dhe në nivel rajonal dhe global - bashkëpunim i jashtëm. Në këtë drejtim, niveli i brendshëm i bashkëpunimit do të duhet të zhvillohet në dy formate: (1) në mes të institucioneve - bashkëpunim ndërinstitucional dhe (2) në mes të institucioneve dhe publikut - bashkëpunim gjithëpërfshirës. Sa i përket bashkëpunimit të jashtëm, i njëjti duhet të zhvillohet në nivel rajonal, nivel të BE-së, por edhe nivel global. Si palë kontraktuese e Komunitetit të Energjisë, drejtimi afatgjatë strategjik dhe i politikave të Kosovës për energjinë dhe klimën janë gjithnjë e më shumë në linjë me objektivat e Komunitetit të Energjisë dhe përfundimisht me ato të Bashkimit Evropian.³¹

Një nivel i lartë bashkëpunimi është posaçërisht i nevojshëm në identifikimin e potencialeve të Kosovës dhe në krijimin e planeve të strukturuar për diversifikimin e burimeve të energjisë. Kur flitet për investimet në BRE, ka shumë sfida administrative e ligjore, të cilat mund të zgjidhen përmes një komunikimi të mirëfilltë me publikun (posaçërisht bizneset) dhe mbi të gjitha përmes një bashkëpunimi e koordinimi institucional. p.sh., thjeshtimi i procedurave për investime në solare, ku për momentin janë të përfshira 3 institucione (Kompania Kosovare për Distribuim me Energji Elektrike - KEDS, Zyra e Rregullatorit të Energjisë dhe Komuna përkatëse), kërkohen rreth 15 dokumente të ndryshme dhe deri në tre muaj kohëzgjatje e procedurave.³² Prandaj, bashkëpunimi e bashkëveprimi i institucioneve mes vete, e edhe i tyre me sektorin privat, ka rol kyç në zbutjen e efekteve të tranzicionit të energjisë, respektivisht duke investuar në rraftësimin e fuqisë punëtore dhe në infrastrukturë të re, duke përmirësuar efikasitetin e energjisë në ndërtesa, duke implementuar skema për të lehtësuar punësimin në sektorët e rinj dhe ato në tranzicion, etj.³³

1.3. Targetimi i duhur i grupeve të ndjeshme më të afektuara nga tranzicioni

Një ndër parimet kryesore të tranzicionit të gjelbër, sipas Agjendës së Gjelbër të Bashkimit Evropian, është parimi që i njëjti duhet të jetë i drejtë dhe të mos e lërë asnjë person dhe asnjë vend prapa.³⁴ Kosova, si palë nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe si shtet që aspiron anëtarësim në BE, pritet të harmonizohet me legjislacionin dhe objektivat e unionit për energji, e në këtë rast të qëndrojë prapa parimeve të tilla. Bazuar në raportin e Komunitetit të Energjisë për Deklaratën e BP6

³¹ Qeveria e Republikës së Kosovës. Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës 2022-2031. <https://me.rks.gov.net/energjia/>. 3 tetor 2023.

Intervistat e BGF me kompanitë e energjisë solare në Kosovë., gusht 2023.

³² Mekanizmi i Tranzicionit të Drejtë - Komisioni Evropian. https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/priorities-2019-2024/european-green-deal/finance-and-green-deal/just-transition-mechanism_en, 22 dhjetor 2023.

³³ Rajonal, Këshilli i Bashkëpunimit. Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal | Deklarata e Sofjes për Agjendën Gjelbër për Ballkanin Perëndimor. <https://www.rcc.int/docs/546/sofia-declaration-on-the-green-agenda-for-the-western-balkans-rn>. 15 gusht 2023.

³⁴ Faqja kryesore e Komunitetit të Energjisë.. <https://www.energy-community.org/#:~:text=About%20us,EXPRESS%20YOUR%20INTEREST>, 22 dhjetor 2023.

për Sigurinë e Energjisë dhe Tranzicionin e Gjelbër, politikat ekzistuese në shtetet e Ballkanit Perëndimor nuk arrijnë që ta trajtojnë në mënyrë efektive varfërinë energjetike.³⁵

Një tranzicion i drejtë e që nuk lë asnjë prapa arrihet duke dizajnuar dhe aplikuar skema dhe masa afatgjata dhe afatshkurtra për të përmirësuar situatën financiare në amvisëri, për të nxitur efijencën e energjisë dhe për të përmirësuar mbrojtjen e konsumatorëve të ndjeshëm.³⁶ Përderisa ndryshimet në punësim si rrjedhojë e tranzicionit do të vërehen në të gjithë sektorët, disa prej tyre si: agrikultura, pylltaria, peshkimi, industritë e prodhimeve intensive, energjia, ndërtimtaria, transporti dhe riciklimi do të preken më intensivisht.³⁷ Në këtë drejtim, ekzistojnë shqetësime për pabarazitë që mund të krijohen, sidomos në aspektin gjinor, e për të cilat PKEK-u nuk parasheh mekanizma ose masa konkrete.

Në draftin aktual të PKEK-ut, në përgjithësi mungon vëmendja dhe targetimi i duhur i grupeve të ndjeshme të shoqërisë, si: gratë, fëmijët dhe minoritetet, dhe ata që janë më të prekur nga tranzicioni. Një analizë gjinore duhet të merret parasysh në hartimin e politikave dhe masave për t'u siguruar se gratë dhe grupet e tjera të ndjeshme përfitojnë në mënyrë të barabartë nga këto politika. Mbi të gjitha mungon planifikimi për përkrahje të rajoneve më të prekura nga tranzicioni. Qeveria, në planet e saj strategjike të energjisë dhe klimës, do të duhet të parashohë informimin e grupeve ose të rajoneve më të prekura, në rastin konkret në Obliq, lidhur me objektivat për dekarbonizim dhe atë që këta objektiva nënkuptojnë për këta punëtorë ose qytetarë në 10-30 vitet e ardhshme.³⁸ Tutje, është i nevojshëm përcaktimi i mekanizmave dhe i mjeteve për të siguruar që punëtorët e industrive tradicionale nuk mbesin prapa, duke ndarë investime në industri dhe infrastrukturë të re, duke i mbështetur punëtorët dhe komunitetet, duke krijuar politika që sigurojnë ndarje të barabartë të përfitimeve nga tranzicioni, duke dhënë incentiva që promovojnë kursimin e energjisë, duke investuar në riaftësim dhe trajnime, etj.³⁹ Sa i përket sektorit privat, duhet të parashihen masa konkrete si: investim në aktivitete të hulumtimit dhe inovacionit, qasje më e lehtë në kredi dhe mbështetje financiare, krijim i kushteve për investitorët privatë e publikë, etj.⁴⁰

³⁵ Faqja kryesore e Komunitetit të Energjisë. <https://www.energy-community.org/#:~:text=About%20us,EXPRESS%20YOUR%20INTEREST>, 22 dhjetor 2023.

³⁶ Po aty.

³⁷ Organizata Ndërkombëtare e Punës. Një kalim i drejtë drejt një të ardhme të qëndrueshme, hapat e ardhshëm për Evropën. Nëntor 2017. https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---ilo-brussels/documents/publication/wcms_614024.pdf.

³⁸ Intervista e BGF me një ekspert të energjisë, Nëntor 2023.

³⁹ "Shkurtimi i Barrierave të Tranzicionit të Drejtë në Evropë." <https://www.climate-kic.org/news/breaking-down-barriers-to-a-just-transition-in-europe/>. 22 dhjetor 2023. Gjithashtu, shihni Faqen kryesore të Komunitetit të Energjisë. <https://www.energy-community.org/#:~:text=About%20us,EXPRESS%20YOUR%20INTEREST> 22 dhjetor 2023.

⁴⁰ Mekanizmi i Tranzicionit të Drejtë - Komisioni Evropian. https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/priorities-2019-2024/european-green-deal/finance-and-green-deal/just-transition-mechanism_en. 22 dhjetor 2023.

1.4. Investim në shkencë, inovacion dhe teknologji

Investimet në shkencë, inovacion dhe teknologji luajnë rol kyç në arritjen e objektivave klimatike për 0 emetime deri në 2050 në nivel të kontinentit. Investimi në këto fusha ndikon, ndër të tjera, në përmirësimin e jetës, përmirësimin e procesit të prodhimit, por edhe në qasjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.⁴¹

Ligji Nr. 04/l-135 për Veprimtari Kërkimore Shkencore thotë se Kosova duhet të alokojë 0.7% të buxhetit vjetor për shkencë dhe inovacion.⁴² Mirëpo, në praktikën e deritanishme buxheti i alokuar për shkencë nga të gjitha qeveritë nuk e ka kaluar vlerën prej 0.1% të buxhetit të Kosovës, gjë që e lë vendin prapa në krahasim me shtetet e tjera të rajonit.⁴³

Duke njohur rëndësinë e investimeve në këtë fushë, Kosova duhet të prioritetizojë ngritjen e investimeve në shkencë, inovacion dhe teknologji dhe të vendos objektiva të qartë që priten të arrihen. Mungesa e resurseve mbetet sfida në këtë drejtim, mirëpo një përkushtim më i madh në këtë aspekt i ndihmon Kosovës ta përballojë më mirë tranzicionin, duke e përgatitur edhe fuqinë punëtore për kërkesat e reja të tregut. Kjo mund të arrihet përmes rikualifikimit dhe përmirësimit të aftësive të punëtorëve. Investimi në digitalizim, trajnimi i auditorëve dhe ekspertëve të eficientës, trajnimi i punëtorëve për të kryer rinovime ndërtesash me cilësi të mirë dhe për të ndërtuar ndërtesa shumë eficiente, trajnimi i punëtorëve për instalimin e paneleve solare dhe pompave termike etj., janë hapa kyç në këtë aspekt.⁴⁴ Ndërtimi i një qendre të inovacionit në Obiliq mund të jetë po ashtu një mundësi e mirë për të përgatitur popullsinë në atë rajon për nevojat e reja të tregut.⁴⁵

1.5 Rritja e pjesëmarrjes së burimeve të ripërtëritshme të energjisë

Pjesëmarrja e energjisë së ripërtëritshme në sektorin e energjisë elektrike aktualisht qëndron në 6.3%, e dominuar nga burimet e bazuara në biomasa që përdoren për ngrohje.⁴⁶ Për t'i arritur objektivat e Komunitetit të Energjisë për vitin 2030,⁴⁷ por edhe

⁴¹ Teknologjitë Mjedisore dhe Klimatike. 2021, vol. 25, nr. 1, faqe 29–4. <https://doi.org/10.2478/rtuect-2021-0003>. <https://content.sciendo.com>.

⁴² Republika e Kosovës, Ligji Nr. 04/l-135 për Veprimtari Kërkimore Shkencore.

⁴³ Republika e Kosovës. Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë 2025-2030, versioni përfundimtar. <https://www.energy-community.org/implementation/package/NECP.html>

⁴⁴ Dokument Pozicioni: Plani Kombëtar i Kosovës për Energji dhe Klimë (PKEK). Maj 2022. <https://kallxo.com/wp-content/uploads/2022/05/Final-position-paper-alb-1.pdf>.

⁴⁵ Intervista e BGF me një ekspertë të energjisë. Nëntor 2023.

⁴⁶ Republika e Kosovës. Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë 2025-2030, versioni përfundimtar. <https://www.energy-community.org/implementation/package/NECP.html>.

⁴⁷ Objektivat e Pakos së Energjisë së Pastër. <https://www.energy-community.org/implementation/package/CEP.html> 22 dhjetor 2023.

edhe për harmonizim me legjislacionit e BE-së, Kosovës i duhet të fokusohet në rritjen e pjesëmarrjes së burimeve të ripërtëritshme në transport dhe energji elektrike - fusha këto në të cilat qëndron prapa sa i përket pjesëmarrjes së BRE.⁴⁸ Në përgjithësi, Kosovës i duhet t'i intensifikojë përpjekjet për të rritur investimet në energji të ripërtëritshme në aspektin legjislativ, administrativ e teknik që të arrijë objektivin për të paktën 31% energji të ripërtëritshme deri në vitin 2030.⁴⁹

Në fushën e energjisë solare Kosova ka potencial të mirë për zhvillim, me rreth 240 ditë me diell në vit.⁵⁰ Megjithatë, bizneset dhe ekspertët e energjisë theksojnë nevojën për thjeshtim të procedurave dhe heqje të pengesave burokratike të cilat e vështirojnë shfrytëzimin e potencialeve të vendit dhe zgjasin periudhën e kthimit të fitimit të investimit.⁵¹

Sa i përket energjisë së erës, pozita gjeografike e Kosovës e bën vendin të përshtatshëm për zhvillim në këtë fushë, si për projekte të vogla ashtu edhe për të mëdha.⁵² Sipas atlasit të Bankës Botërore, komunat: Pejë, Dragash, Prizren, Gjakovë, Istog, Podujevë, Shtërpcë dhe Kaçanik kanë potencial më të madh për vendosje të turbinave të erës në krahasim me komunat e tjera, por gjithashtu kërkojnë investime të mëdha financiare.⁵³

Gjenerimi i energjisë përmes ujit apo hidroenergji mbetet jashtë planeve të qeverisë sipas Strategjisë së Energjisë së Kosovës, ku thuhet se për shkak të aspekteve mjedisore, Strategjia nuk promovon ndërtimin e hidrocentraleve. Kjo vjen si pasojë e një plani jorealistik të qeverisë për të shtuar 240 MV kapacitet të hidroenergjisë në vitin 2013, iniciativë kjo që ka shkaktuar dëme të mëdha mjedisore.⁵⁴

Në vitin 2020, Kosova arriti objektivin për burime të ripërtëritshme në nivel të Komunitetit të Energjisë, por vetëm falë biomasës. Megjithatë pjesëmarrja e BRE-ve në sektorin e transportit mbetet e ulët.⁵⁵

⁴⁸ Komuniteti i Energjisë. Raporti Vjetor i Kosovës* për Zbatim. 1 Nëntor 2022. https://www.energy-community.org/dam/jcr:dbe6d342-ea7d-4677-9a9b-c18f22a1cfad/IR2022_Kosovo.pdf. 18 tetor 2023.

⁴⁹ Objektivat e Pakos së Energjisë së Pastër. <https://www.energy-community.org/implementation/package/CEP.html>. 22 dhjetor 2023.

⁵⁰ Bizneset në Kosovë po përfitojnë nga avantazhet e energjisë së gjelbër me ndihmën e BE-së. | EEAS.

https://www.eeas.europa.eu/delegations/kosovo/kosovo-businesses-reaping-benefits-green-energy-help-eu_en?s=321.

⁵¹ Intervistat e BGF me kompani solare në Kosovë, gusht 2023.

⁵² "Pajisja e investitorëve dhe zhvilluesve me mjetet e nevojshme për shfrytëzimin e potencialit me energji të ripërtëritshme në Kosovë | Lajme | Kosovë." Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar. 27 mars 2023,

<https://www.usaid.gov/kosovo/news/mar-27-2023-equipping-investors-and-developers-tools-they-need-leverage-kosovos-renewable-energy-potential>.

⁵³ Atlasi Global i Erës <https://globalwindatlas.info>. 22 dhjetor 2023. Gjithashtu, shih Ahmeti, Nadije. "Kosova e varfër sa i përket energjisë alternative." Radio Evropa e Lirë, 12 janar 2017. <https://www.evropaelire.org/a/28226200.html>.

⁵⁴ "Kosova bëhet vendi i parë në Ballkanin Perëndimor që ndalon promovimin e hidroenergjisë së re" Bankwatch, <https://bankwatch.org/blog/kosovo-becomes-the-first-western-balkan-country-to-stop-promoting-new-hydropower>. 22 dhjetor 2023. Gjithashtu, shih Preporrt. "Përkeqësimi Ambiental nga Hidrocentralet. – Investigimi." Preporrt, <https://preporrt.cohu.org/en/investigations/Environmental-degradation-by-hydropower-plants-356>. 22 dhjetor 2023.

⁵⁵ Stamatoukou, Eleni "Botohet raporti i shkurtër për Politikën e Energjisë së Ripërtëritshme në Kosovë" BIRN, 1 korrik 2021, <https://birn.eu.com/news-and-events/position-paper-on-kosovos-renewable-energy-policy-published/>.

Prandaj duke u nisur nga përvoja me vendosjen e caqeve jorealitike dhe, në anën tjetër, duke konsideruar varësinë e madhe në qymyr, qeveria duhet të bëjë një analizë të detajuar dhe përshtatje apo adaptim të objektivave për të qenë në harmoni me potencialet energjetike, por dhe kapacitetet financiare të saj. Por mbi të gjitha, duhet të sigurohet në evitimin e vonesave në implementim, siç është rasti i ankandëve solare.

1.6 Diversifikimi i burimeve të energjisë

Një ndër prioritetet kryesore të Kosovës në aspektin e energjisë duhet të jetë diversifikimi i burimeve të energjisë, sidomos duke konsideruar faktin që rreth 77.7% e energjisë elektrike në vend gjenerohet nga një burim i vetëm - qymyri. Një mbështetje e tillë në një burim të vetëm të energjisë ndikon në shkëputje të energjisë si pasojë e mungesës së furnizimit, por edhe në luhatje të çmimeve.⁵⁶ Strategjia e Kosovës e ka të vendosur sigurinë e furnizimit në qendër të saj,⁵⁷ por në sigurinë e furnizimit ndikon edhe diversifikimi i burimeve të energjisë.

Aktualisht, bazuar në Strategjinë për Energji të Kosovës, përzierja e kapaciteteve në Kosovë sa i përket vitit 2021 ishte si në vijim:

⁵⁶ Diversifikimi i Energjisë - Edukimi në Energji.

https://energyeducation.ca/encyclopedia/Energy_diversification#:~:text=Diversification%20allows%20for%20a%20society,or%20solar%20energy%20for%20example. 22 dhjetor 2023.

⁵⁷ Qeveria e Republikës së Kosovës. Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031. <https://me.rks-gov.net/energija/>. 3 tetor 2023.

Karburanti	Emri	Viti i vënies në punë	Kapaciteti i instaluar, MV	Kapaciteti i disponueshëm, MV
Linjiti	Kosova A3	1970	200	138
	Kosova A4	1971	200	138
	Kosova A5	1975	210	138
	Kosova B1	1983	339	305
	Kosova B2	1984	339	305
Era	-	-	137	-
Uji	-	-	101	-
Diellore fotovoltaike	-	-	10	-
Biomasa	-	-	1.2	-
Totali	-	-	1537	-

Diversifikimi i burimeve të energjisë i mundëson vendit siguri dhe stabilitet të furnizimit dhe pavarësi energjetike, sidomos duke i konsideruar potencialet ekzistuese dhe pamundësinë për t'i plotësuar të gjitha nevojat energjetike të vendit tonë me një lloj BRE-je. Një diversitet i burimeve të energjisë ndër të tjera eviton edhe lëvizjet e çmimeve.

1.7. Targetimi i konsumit të tepërt të energjisë

Qeveria e Kosovës, me veçanti Ministria e Ekonomisë, e kanë bërë të qartë tashmë që kanë prioritet eficientë e energjisë.⁵⁸ Megjithatë duhet të shtohen përpjekjet për targetimin në nivel më të gjerë të konsumit të tepërt të energjisë përmes iniciativave që i zvogëlojnë humbjet e mëdha në rrjet, përdorimin e objekteve joefiçente dhe teknologjive të vjetruara.

⁵⁸ Instituti GAP, <https://www.institutigap.org/lajme/3105>. 10 janar 2024.

Nga masat e qeverisë për efikasitet kanë përfituar një numër i kënaqshëm i qytetarëve, megjithatë ka nevojë për shtrirje të skemave për të përfshirë të gjitha kategoritë e shoqërisë dhe, si rrjedhojë, për ta rritur numrin e përfituesve. Në drejtim të efikasitetit të energjisë, Sekretariati po ashtu rekomandon të miratohen plotësim-ndryshimet në Ligjin për Efikasitet të Energjisë.⁵⁹ Përveç kësaj, është e domosdoshme të zbatohen masa më sistematike për efikasitetin e energjisë dhe jo qasje ad-hoc, duke siguruar një plan të qëndrueshëm dhe afatgjatë që do të përfshijë standarde të qarta dhe masa të koordinuara në nivel kombëtar.

Duke konsideruar humbjet teknike të Kosovës në rrjetin e shpërndarjes prej 12.21% (sipas të dhënave të vitit 2022), të cilat janë dyfish më të larta krahasuar me mesataren e BE-së (6-8%),⁶⁰ është i rëndësishëm modernizimi i rrjetit të shpërndarjes dhe zvogëlimi i humbjeve, por mbi të gjitha zvogëlimi i konsumit të energjisë.

1.8. Avancimi i kornizës ligjore

Ligji për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë, Ligji për Energjinë Elektrike dhe Ligji për Rregullatorin e Energjisë veç se janë miratuar. Miratimi i këtyre ligjeve është shumë i rëndësishëm për tranzicionin energjetik të Kosovës. Një hap i rëndësishëm është bërë me miratimin e Ligjit për Ndryshimet Klimatike 2019-2028, ku bashkë me të është miratuar edhe Plan i Veprimit për Përshtatje në Ndryshime Klimatike.⁶¹ Një ligj i tillë ka rëndësi të madhe sepse vendos bazën për ta përgatitur shoqërinë tonë përballë ndikimeve të ndryshimeve klimatike.⁶²

Sa i përket kornizës ligjore, vlen të theksohet edhe rekomandimi i Sekretariatit për miratimin e plotësim-ndryshimeve në Ligjin për Efikasitet të Energjisë për të qenë në linjë me targetet më ambicioze sipas Direktivës për Efikasitet të Energjisë.⁶³ Ky ligj, është në plan të transpozohet deri në fund të vitit 2024.

Avancimi i kornizave ligjore për të qenë në harmoni me legjisllacionin e BE-së dhe caqet (targetet) e Kosovës për energji dhe klimë kanë qenë një proces i rëndësishëm në implementim të këtyre targeteve dhe në arritjen e tranzicionit të energjisë.

⁵⁹ Qeverisja dhe PKEK. <https://www.energy-community.org/implementation/package/NECP.html> 12 janar 2024.

⁶⁰ Qeveria e Republikës së Kosovës. Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës 2022-2031. <https://me.rks.gov.net/energjia/>. 3 tetor 2023.

⁶¹ Gazeta Zyrtare, "Ligji Nr. 08/L-250 për Ndryshimet Klimatike", Kosovë, 2024, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=85112>

⁶² Kosovë, Energjia në. "Risi Në Kosovë: Miratohet Projektligji Për Ndryshimet Klimatike." 13 korrik 2023, <https://kosovo.energy/risi-ne-kosove-miratohet-projektligji-per-ndryshimet-klimatike/>.

⁶³ Qeverisja dhe PKEK. <https://www.energy-community.org/implementation/package/NECP.html>. 15 janar 2024

1.9. Dekarbonizimi në sektorin e transportit dhe të ngrohjes

Sipas të dhënave të BE-së, sektori i transportit është përgjegjës për ¼ e emetimeve të gazrave serrë në nivel të Bashkimit Evropian dhe është sektori më i madh për nga emetimet sipas objektivave të shteteve anëtare që nuk janë të përfshira në ETS.⁶⁴

Kosova, në planin e saj për energji dhe klimë, do të duhej t'i kushtojë vëmendje më e madhe zhvillimit të transportit publik – si urban ashtu edhe ndërurban – dhe transportit të pamotorizuar, si ecja, çiklizmi dhe elektromobiliteti.⁶⁵ E-mobiliteti synohet si objektiv nga ana e Kosovës, por jo në mënyrën që do të duhej. Planifikimi dhe investimi në infrastrukturën përkatëse të lëndëve djegëse alternative si biokarburantet dhe hidrogjeni, si dhe një koordinim efektiv për përhapjen e sistemeve inteligjente të transportit janë thelbësore për t'i arritur standardet e emetimit të CO₂ për 2025 dhe 2030 dhe për të reduktuar koston.⁶⁶ Dekarbonizimi i sektorit të transportit do të ndikojë dukshëm në përmirësimin e cilësisë së ajrit, gjë që në gjendjen aktuale ka implikime të dëmshme shëndetësore për qytetarët e Kosovës.

Sa i përket sektorit të ngrohjes, është i nevojshëm modernizimi i rrjetit të ngrohjes qendrore, shtrirja e sistemit në qytetet e tjera të Kosovës, shfrytëzimi i burimeve të ripërtëritshme në ngrohje dhe implementimi i teknologjisë me efikasitet të lartë.⁶⁷

Përndryshe ngritja e caktuar për pjesëmarrje të burimeve të ripërtëritshme në transport dhe ngrohje për vitin 2030 është rekomanduar edhe nga ana e Sekretariatit: prej 3.6% në 7% në sektorin e transportit dhe prej 49.6% në 62.4% në sektorin e ngrohjes.⁶⁸ Mirëpo, e njëjta duhet të shoqërohet nga vendosja e masave dhe targeteve konkrete për rritje të pjesëmarrjes së burimeve të ripërtëritshme në këta sektorë, pasi që shumë shpejtë do të jetë obligative për të gjithë shtetet e ballkanit.

⁶⁴ Komunikata nga Komisioni drejtuar Parlamentit Evropian, Këshillit, Komitetit të Ekonomisë dhe Social Evropian dhe Komitetit të Rajoneve të Bashkuara në realizimin e Unionit të Energjisë dhe Veprimeve Klimatike - Vendosja e bazave për një tranzicion të suksesshëm në Energji të Pastër. 2019, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?qid=1565713062913&curi=CELEX:52019DC0285>.

⁶⁵ Dokument Pozicioni: Plani Kombëtar i Kosovës për Energji dhe Klimë (PKEK). Maj 2022. <https://kallxo.com/wp-content/uploads/2022/05/Final-position-paper-alb-1.pdf>.

⁶⁶ Komunikata nga Komisioni drejtuar Parlamentit Evropian, Këshillit, Komitetit të Ekonomisë dhe Social Evropian dhe Komitetit të Rajoneve të Bashkuara në realizimin e Unionit të Energjisë dhe Veprimeve Klimatike - Vendosja e bazave për një tranzicion të suksesshëm në Energji të Pastër. 2019, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?qid=1565713062913&curi=CELEX:52019DC0285>

⁶⁷ Webfaqja e Komunitetit të Energjisë. <https://www.energy-community.org/#:~:text=About%20us,DOWNLOAD%20THE%20NEW%20REPORT>. 22 dhjetor 2023.

⁶⁸ Qeverisja dhe PKEK. <https://www.energy-community.org/implementation/package/NECP.html> 11 janar 2024.

Konkluzione

Kosovës i duhet të përkushtohet më intensivisht në zvogëlimin e varësisë në qymyr, gjë që ka implikime të dëmshme mjedisore, por edhe shëndetësore për qytetarët e saj. Largimi i qymyrit, si rrjedhojë, përbën një ndër objektivat kyç për të gjithë kontinentin deri në vitin 2050, gjë që Kosova e ka të vendosur edhe në Strategjinë e Energjisë. Megjithatë e njëjta nuk vlen edhe për Planin Kombëtar për Energji dhe Klimë, si dokument strategjik 10-vjeçar i vendit në fushën e klimës dhe energjisë, dhe i cili është në proces të finalizimit.

Në korrik të vitit të kaluar (2023), Kosova ka dërguar draftin e PKEK-ut në Sekretariat të Komunitetit të Energjisë, ndërkaq në dhjetor ka pranuar rekomandimet nga i njëjti. Tani asaj i duhet të fokusohet në përcaktim më të detajuar të masave dhe politikave në sektorë të ndryshëm e sidomos sa i përket energjisë së ripërtëritshme, efikasitetit të energjisë dhe funksionimit të tregut të brendshëm. Duke analizuar PKEK-un dhe Strategjinë e Energjisë, Balkan Green Foundation ka identifikuar disa nga çështjet që do t'i kontribuojnë Kosovës në finalizimin e PKEK-ut dhe në procesin e tranzicionit të energjisë për të arritur caqet për vitin 2030 dhe 2050 në kuadër të Komunitetit të Energjisë, por mbi të gjitha edhe të Bashkimit Evropian.

Në këtë drejtim nevojitet bashkëpunim e bashkëveprim në mes të akterëve për arritje të qëllimeve të përbashkëta, përcaktim më i detajuar i hapave dhe i masave për secilin sektor, avancim i kornizës ligjore dhe targetim i grupeve të ndjeshme të shoqërisë. Më tutje, Kosova duhet të punojë drejt rritjes së pjesëmarrjes së burimeve të ripërtëritshme, efikasitetit të energjisë, investimit në shkencë, teknologji dhe inovacion si dhe diversifikimit të burimeve të energjisë.

